

RAPORT I AUDITIMIT

Titulli i Projektit/Aktivitetit:

***Olimpiada Evropiane E Vajzave Në Matematikë (EGMO)
2025***

Përfituesi:

SHOQATA E MATEMATIKANËVE TË KOSOVËS (SHMK)

Organizatë Jo-Qeveritare (OJQ)

PROJEKT I FINANCUAR NGA

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Numri i vendimit të financimit: 07/224 (11.10.2024)

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITORIT PËR QËLLIME TË VEQANTA.....	3
A. PRANIMET DHE DISBURSIMET E PARAVE TË GATSHME	5
B. LISTA E SHPENZIMEVE	6
1. Të përgjithshme.....	7
1.1 Objektiva e projektit dhe aktivitetet e realizuara	8
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacionit të përgjithshëm.....	8
3. Fondet e pranuar.....	9

RAPORTI I AUDITORIT PËR QËLLIME TË VEQANTA

Për: Shoqatën e Matematikanëve të Kosovës (SHMK) – Projekti/Aktiviteti 'Olimpiada Evropiane E Vajzave Në Matematikë (EGMO) - 2025'

Opinionit

Ne kemi audituar raportin financiar të projektit 'Olimpiada Evropiane E Vajzave Në Matematikë (EGMO) - 2025' të implementuar nga OJQ Shoqata e Matematikanëve të Kosovës (SHMK), të financuar nga Qeveria e Kosovës për vitin 2025 duke përfshirë shpenzimet totale 200,000 Euro (€) dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacioneve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, raporti financiar i projektit 'Olimpiada Evropiane E Vajzave Në Matematikë (EGMO) - 2025' është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me dispozitat financiare të Kornizës së Raportimit Financiar në Kosovë.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrës së pranimeve dhe disbursimeve* pjesë e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përfuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes – baza e kontabilitetit dhe kufizimi i shpërndarjes dhe përdorimit

Ju tërheqim vëmendjen në Shënimin 2.2 të raportit financiar, i cili përshkruan bazën e kontabilitetit. Ky raport financiar është përgatitur për të ndihmuar subjektin që të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar. Rrjedhimisht, raporti financiar mund të mos jetë i përshtatshëm për ndonjë qëllim tjetër. Raporti ynë i drejtohet vetëm Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës (SHMK) dhe Zyrës së Kryeministrit dhe nuk duhet të shpërndahet ose përdoret nga palët tjera. Opinioni ynë nuk është modifikuar sa i përket kësaj çështjeje.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

OJQ SHMK është përgjegjës për përgatitjen e raportit financiar në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të shënimin 2.2, kjo përfshin përcaktimin e bazës së kontabilitetit se pasqyra e pranimeve dhe disbursimeve është një bazë e pranueshme për përgatitjen e këtij raporti dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrës së pranimeve dhe disbursimeve pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrës së pranimeve dhe disbursimeve, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit të vijoje sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit

bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likujdojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyra e pranimeve dhe disburseve si tërësi nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrës së pranimeve dhe disburseve, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës së pranimeve dhe disburseve, përfshirë shpalosjet, dhe nëse pasqyra e pranimeve dhe disburseve përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi, Auditor LIGJOR, CertIFR, VLP
Partner, QUATRA AUDIT Int. LLC

Prishtinë,
23 qershor 2025

P: +383 (0) 44 377 873 ♦ E: lulzimkrasniqi@gmail.com
A Sheshi Nëna Terezë, H1, Nr.2, Prishtina, Kosova
Licenca KKRf Nr: 80 ♦ Nr.Scaak: 2088



Shoqata e Matematikanëve të Kosovës (SHMK)
'Olimpiada Evropiane E Vajzave Në Matematikë (EGMO) - 2025'
Projekt i financuar nga Qeveria e Kosovës
Për vitin 2025

A. PRANIMET DHE DISBURSIMET E PARAVE TË GATSHME

Bilanci i hapjes	EUR (€)
Para në dorë	-
Para në bankë	-
Të arkëtueshmet	-
Detyrimet	-
Bilanci total i hapjes	-
FONDET DHE SHPENZIMET E PROJEKTIT	
Fondet e marra (Qeveria/Thesari – 21.10.2024)	200,000
Fondet e tjera	-
Shpenzimet për periudhën	(200,000)
Fondet e kthyer	-
Bilanci i projektit	-
Bilanci i mbylljes	
Para në dorë	-
Para në bankë	-
Të arkëtueshmet	-
Detyrimet	-
Bilanci total i përfundimit	-
Diferenca	-

Raporti financiar është aprovuar dhe nënshkruar në emër të bordit më datën 13.06.2025.

Kryetarja: Valdete Rexhëbegaj Hamiti



Shoqata e Matematikanëve të Kosovës (SHMK)
'Olimpiada Evropiane E Vajzave Në Matematikë (EGMO) - 2025'
Projekt i financuar nga Qeveria e Kosovës
Për vitin 2025

B. LISTA E SHPENZIMEVE

Emërtimi i shpenzimeve	Shpenzimet aktuale të periudhës (€)
Pagesat për sallën e ceremonisë hapëse (12.04.2025) dhe për ceremoninë mbyllëse (16.04.2025)- <i>KlanArena</i>	1,200
Pagesat për grupet pjesëmarrëse, mysafirëve dhe aktiviteteve tjera përcjellëse (fjetja, ushqimi, shfrytëzimi i sallave të konferencave për nxënëset, liderët dhe zëvendësliderët e grupeve, anëtarët e bordit të EGMO, koordinatorët, anëtarët e grupit punës të detyrave) - <i>Professional Event Planner LLC</i>	175,490
Pagesat për transport (ajror, tokësor) – <i>Mjellma Travel</i>	19,080
Pagesat për mirëmbajtje/hostim - <i>ProEd</i>	3,000
Pagesat për dizajn dhe të tjera - <i>GanDesign</i>	1,204
Pagesat për komisione bankare/tjera	26
TOTAL (Kostoja e Përgjithshme)	200,000
TOTAL (Sipas Grantit Qeveritar)	200,000
Diferenca	-

Raporti financiar është aprovuar dhe nënshkruar në emër të bordit më datën 13.06.2025.

Kryetarija: Valdete Rexhepaj Hamiti



1. Të përgjithshme

Shoqata e Matematikanëve të Kosovës (SHMK), me adresë në rrugën Nëna Terezë, 10000, Prishtinë, Kosovë dhe me numër të regjistrimit të OJQ-së 5112119-8. Shoqata e Matematikanëve të Kosovës (SHMK) është themeluar, më 22 gusht 2008, në Prishtinë me qëllim të Avancimit të kapaciteteve ekzistuese dhe ngritjes së kapaciteteve të reja për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe pedagogjike në fushën e matematikës së pastër dhe të zbatuar.

Bordi i SHMK ka këtë përbërje:

Valdete Rexhëbeqaj – Hamiti, Kryetare

Anëtarët e bordit të SHMK:

Armend Shabani

Shkumbin Makolli

Valmir Krasniqi

Besfort Shala

Festim Shkodra

Agim Maliqi

Për t'i përmbushur qëllimet e saj, SHMK ndërmerr, por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve:

- (a) Organizimin dhe mbështetjen e seminareve, konferencave, forumeve apo formave të tjera të organizimeve publike;
- (b) Publikimin dhe blerjen e revistave, librave, e materialeve të tjera shkencore e profesionale;
- (c) Bashkëpunimin e nevojshëm me organizmat, shoqatat, institucionet, dhe individët brenda dhe jashtë vendit;
- (ç) Organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme (si, p.sh., gara, shkolla sezonale, seri kursesh etj.) për të rinjtë e interesuar për matematikë;
- (d) Organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme (si, p.sh., seri kursesh ose ligjëratash) për mësime të avancuara, për avancimin e cilësisë në mësimdhënie.

1.1 Objektiva e projektit dhe aktivitetet e realizuara

Olimpiada Evropiane e Vajzave në Matematikë (EGMO 2025) u zhvillua në Prishtinë nga 11 deri më 17 prill 2025, me pjesëmarrjen e 56 ekipeve nga Evropa dhe vende ftuese. **Gjithsej ishin 460 pjesëmarrës (organizatorë, shoqërues profesional, vullnetare dhe gjithsej 219 garuese).** Gjatë dy ditëve të garës u testuan gjashtë probleme matematikore, prej nga dolën 27 medalje ari, 38 medalje argjendi, 53 medalje bronzi dhe 52 mirënjohje nderi, duke e pozicionuar Kosovën si organizatore të një ngjarjeje shkencore prestigjioze ndërkombëtare.

Në përkrahje të këtij aktiviteti, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 07/224 të datës 11.10.2024, ka ndarë mjete buxhetore në vlerë prej 200, 000 €; fondet u transferuan në xhirollogarinë e Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës (SHMK) për mbulimin e shpenzimeve të organizimit.

Lista e aktiviteteve të financuara nga granti Qeveritar:

- Rezervimi i sallës Klan Arena për ceremoninë hapëse (12.04.2025) dhe për ceremoninë mbyllëse (16.04.2025);
- Mirëmbajtja dhe hostimi i webfaqes <https://egmo2025.com/> për 10 vjet;
- Biletat e udhëtimit për anëtarët e bordit të EGMO, për koordinatorët e ngjarjes dhe anëtarët e grupit punes të detyrave;
- Akomodimi në shtatë (7) hotele (fjetja, ushqimi, shfrytëzimi i sallave të konferencave) për pjesëmarrësit në EGMO 2025 (nxënëset, liderët dhe zëvendësliderët e grupeve, anëtarët e bordit të EGMO, koordinatorët, anëtarët e grupit punes të detyrave shih listën <https://www.egmo.org/egmos/egmo14/people/>);
- Medaljet për nxënëset fituese.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacionit të përgjithshëm

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyra shoqëruese e pranimeve dhe disbursimeve është përgatitur mbi bazën e parasë së gatshme të kontabilitetit. Prandaj, të ardhurat dhe shpenzimet njihen kur pranohen dhe paguhen përkatësisht. Pasqyra shoqëruese e pranimeve dhe disbursimeve paraqet aktivitetin e projektit të financuar nga Qeveria e Kosovës dhe jo veprimtarinë e organizatës në tërësi.

2.2 Valuta Raportuese

Valuta raportuese për përgaditjen e Pasqyrës së pranimeve dhe disbursimeve është Euro (EUR), që është monedha ligjore në territorin e Kosovës që nga 1 Janari 2002. Transaksionet në valuta tjera përveq në Euro regjistrohen me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën kurfondet pranohen ose paguhen.

2.3 Tatimi mbi të ardhurat

Shoqata e Matematikanëve të Kosovës (SHMK) është OJQ dhe është themeluar si një organizatë jo profitabile dhe prandaj është e liruar nga tatimi në të ardhurat e korporatave (TAK). Gjatë vitit 2024-2025 nuk ka gjeneruar të hyra, përveq donacioneve, nga aktivitetet ekonomike apo komerciale të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

3. Fondet e pranuar

	<i>Euro</i>
Të hyrat (Qeveria/Thesari – 21.10.2024)	200,000
Total të hyrat	200,000
Rrjedha e parasë	
	<i>Euro</i>
Të hyrat (Qeveria/Thesari – 21.10.2024)	200,000
Të hyrat tjera	-
Total të hyrat	200,000
Pagesat për shpenzime	(200,000)
Obligimet e mbetura	-
Balanci i mbetur	-

4. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korigjim ose shpalosje në raportin financiar.